

**VENDIM**  
**Nr. 651, datë 14.9.2016**

**PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR. 10139, DATË 15.5.2009, “PËR PENSIONET SHTETËRORE SUPLEMENTARE TË PUNONJËSVE TË UNIVERSITETEVE, TË SHKOLLAVE TË LARTA, QENDRËS SË STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE, AKADEMISË SË SHKENCAVE DHE TË GJITHA INSTITUCIONEVE TË TJERA KËRKIMORE PUBLIKE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË, TË CILËT KANË TITUJ SHKENCORË”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 7, 12 e 15, të ligjit nr. 10139, datë 15.5.2009, “Për pensionet shtetërore suplementare të punonjësve të universiteteve, të shkollave të larta, Qendrës së Studimeve Albanologjike, Aka-demisë së Shkencave dhe të gjitha institucioneve të tjera kërkimore publike në Republikën e Shqipërisë, të cilët kanë tituj shkencorë”, të ndryshuar, dhe ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Në zbatim të shkronjës “c”, të pikës 3, të nenit 2, të ligjit nr. 10139, datë 15.5.2009, të ndryshuar, institucionet jopublike, të cilat për-fshihen në këtë skemë për efekt të këtij ligji, janë universitetet, akademitë, kolegjet universitare, kolegjet profesionale të larta, si dhe institutet, qen-drat e agjencitë e kërkimit shkencor të akredituara.

2. Lista e institucioneve të arsimit të lartë hartohet dhe përditësohet nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, sipas kërkesës së Institutit të Siguri-meve Shoqërore.

3. Në zbatim të pikës 4, të nenit 2, të ligjit nr. 10139, datë 15.5.2009, të ndryshuar, “paga referuese” është paga bazë për titullin në institu-cionet publike, duke përjashtuar shtesat për funksion. Për efekt të përcaktimit të përfitimeve, paga referuese llogaritet si mesatare e pagave referuese, sipas viteve të ushtrimit të titullit. Si pagë bazë do të jetë ajo e përcaktuar nga Këshilli i Ministrave.

Për efekt të llogaritjes së përfitimit, për titujt:

a) “Profesorë” dhe “Drejtuës kërkimesh”, të cilët kanë periudhë ushtrimi të titullit, sipas pikës 3, të nenit 2, të ligjit nr. 10139, datë 15.5.2009, të ndryshuar, pagë referuese e titullit do të merret ajo për titullin “Profesor” në institucionet e arsimit të lartë;

b) “Profesorë të asociuar” dhe “Mjeshtër kërkimesh”, të cilët kanë periudhë ushtrimi të titullit, sipas pikës 3, të nenit 2, të ligjit nr. 10139, datë 15.5.2009, të ndryshuar, pagë referuese e titullit do merret ajo për titullin “Profesor i asociuar” në institucionet e arsimit të lartë;

c) “Docent” dhe “Bashkëpunëtor i vjetër shkencor”, të cilët i kanë pasur këta tituj para vitit 1994 dhe i kanë përfituar pasi është fituar më parë grada shkencore “Kandidat i shkencave”, pagë referuese e titullit do merret ajo e pozicionit “Lektor” në institucionet e arsimit të lartë;

4. Në zbatim të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr. 10139, datë 15.5.2009, të ndryshuar, masa e pensionit suplementar plus pensionin e pleqërisë nuk mund të jetë më e madhe se dyfishi i masës së pensionit të caktuar sipas nenit 31/1 ose masës së pensionit të caktuar sipas nenit 32 e 33, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Për personat, të cilëve e drejta për pension suplementar, sipas këtij ligji, u lind pas hyrjes në fuqi të tij, ndërsa pensioni i pleqërisë u llogaritet sipas dispozitave në fuqi deri në 31.12.2014, shuma e pensionit të pleqërisë plus pensionin suplementar nuk mund të jetë më e lartë se dyfishi i masës mujore të pensionit të pleqërisë dhe shtesës së pensionit të pleqërisë sipas nenit 33, në momentin e lindjes së të drejtës për pension suplementar.

5. Kontributet suplementare, sipas masës së përcaktuar në nenin 4, të ligjit nr. 10139, datë 15.5.2009,

të ndryshuar, llogariten nga subjekti punëdhënës dhe derdhen në organet tatimore sipas procedurave dhe afateve të përcaktuara për mbledhjen e kontributeve nga skema e sigurimit shoqëror të detyrueshëm.

6. Organet tatimore dhe të sigurimeve shoqërore nuk do të pranojnë kontribute suplementare për persona që gëzojnë titullin, por e ushtrojnë atë duke punuar në institucione kërkimore publike apo institucione jopublike, të cilat nuk janë të përcaktuara sipas pikës 2, të këtij vendimi.

7. Personat e interesuar për të përfituar pension suplementar sipas ligjit nr. 10139, datë 15.5.2009, të ndryshuar, duhet të paraqesin pranë organeve të sigurimeve shoqërore ku kanë qendrën e tyre të banimit kërkesën për përfitim, të shoqëruar me dokumentacionin e nevojshëm për këtë qëllim, si më poshtë vijon:

- a) Fotokopje të kartës së identitetit;
- b) Fotokopje të noterizuar të dëshmisë për dhënien e titullit ose vërtetim për dhënie titulli nga Komisioni i kualifikimit shkencor apo nga Komisioni i vlerësimit të titujve;
- c) Vërtetim, lëshuar nga qendra e punës, për pagën referuese, si dhe kohën e gëzimit të titullit, në zbatim të ligjit nr. 10139, datë 15.5.2009, të ndryshuar.

8. Shpenzimet administrative për funksionimin e kësaj skeme të përballohen nga buxheti i Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

9. Ngarkohet Instituti i Sigurimeve Shoqërore për zbatimin e këtij vendimi.  
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI  
**Niko Peleshi**